

VENDIM
Nr.814, datë 15.12.2006

**PËR ASISTENCËN EKONOMIKE TË MENJËHERSHME PËR PERSONAT QË
PËRFITOJNË PENSION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç” të nenit 66 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë asistencë të menjëhershme, në shumën 5 000 (pesë mijë) lekë:
 - a) personat, që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - b) veteranët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare që trajtohen me shpërblim mujor, sipas ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, dhe personat që marrin pension për merita të veçanta, sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, të cilët nuk përfitojnë pension pleqërie, invaliditeti apo familjar;
 - c) pensionistët, që marrin pension, sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - c) personat, që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.8685, datë 22.6.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë”, si dhe personat, që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përllogariten në shumën 2 668 000 000 (dy miliardë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë) lekë dhe të përballohen, si më poshtë vijon:
 - a) 800 000 000 (tetëqind milionë) lekë nga kursimet e shërbimit të borxhit të brendshëm;
 - b) 811 000 000 (tetëqind e njëmbëdhjetë milionë) lekë nga kursimi i shpenzimeve korrente në institucionet buxhetore, që rezultojnë në fund të vitit 2006;
 - c) 1 057 000 000 (një miliard e pesëdhjetë e shtatë milionë) lekë nga pakësimi i subvencioneve të Buxhetit të Shtetit, për buxhetin e sigurimeve shoqërore, si pasojë e tejkalimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.
 3. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta t’i shtohet, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, shuma 1 611 000 000 (një miliard e gjashtëqind e njëmbëdhjetë milionë) lekë.
 4. Në programin “Mbrojtja sociale”, të miratuar në buxhetin e vitit 2006, të shtohet shuma 2 668 000 000 (dy miliardë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë) lekë, që të përdoret:
 - a) për asistencën e menjëhershme të pensionistëve, 2 647 425 000 (dy miliardë e gjashtëqind e dyzet e shtatë milionë e katëqind e njëzet e pesë mijë) lekë;
 - b) për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave dhe shpenzimeve administrative, 20 575 000 (njëzet milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.
 5. Procedurat e pagesës së asistencës së menjëhershme për pensionistët të realizohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a.
 6. Ngarkohen Ministria e Financave, ministritë e linjës dhe të gjitha institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha